



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AKADEMIA E SHKENCAVE  
Kryesia

Nr. 95 prot.

Tiranë, më 2 shkurt 2021

V e n d i m

Nr. 10 datë 02.02.2021

*Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e projektligjit  
“Për mbrojtjen dhe përdorimin e njësuar të gjuhës shqipe në funksionet  
publike”*

Kryesia e Akademisë së Shkencave, në mbledhjen e saj të datës 02.02.2021, duke iu referuar *Parashtresës* drejtuar Kryeministrit të Shqipërisë dhe vendimit të Asamblesë së saj për miratimin e programit për vitin 2021,

V e n d o s i:

1. Referuar nenit 14 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Akademia e Shkencave të përgatisë dhe propozojë projektligjin *Për mbrojtjen dhe përdorimin e njësuar të gjuhës shqipe në funksionet publike*;
2. Grupi i punës i ngarkuar me hartimin e këtij projektligji të ketë përbërjen e mëposhtme:
  - Akad. asoc. Kristina Jorgaqi, kryetare;
  - Prof. Seit Mansaku, anëtar
  - Prof. Ardian Vehbiu, anëtar
  - Prof. Mimoza Kore, anëtare
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen kryetari i SSHSHA dhe sekretari shkencor i Akademisë së Shkencave.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

